

Tiranë më 15.01.2024

KËRKESË

KËRKUES:

Prof. Dr. Sali Berisha, i biri i Ram dhe i Shiqere, i datëlindjes 15.10.1944, lindur në Tropojë, me nr. personal E40701031R, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. Genc Gjokutaj dhe av. Sokol Mëngjesi.

Email: smengjesi@yahoo.com nr.tel. 0692618941)

Adresa: Blv. "Bajram Curri", Pallatet "Agimi", Shkalla 4, Ap. 64 (7), kt. II, mbi kafe ROMA, Tiranë.

DREJTUAR:

Prokurorëve **Enkeleda Millonai** dhe **Arben Kraja**

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Adresa Rruga "Jordan Misja", nr. 1, Tiranë, 1000, Shqipëri

OBJEKTI:

Lejimi i z. Sali Berisha, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, që të marrë pjesë në seancat plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të detyrimit që buron nga ky funksion, si person i zgjedhur nga sovrani, për të ushtruar të drejtat dhe liritë politike sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 110 KPrP

Të nderuar z. Prokurorë!

Me Vendimin nr. 112, datë 20.10.2023, Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka caktuar masat e sigurimit të *“Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”* dhe *“Ndalimi i daljes jashtë shtetit”*, parashikuar respektivisht nga nenet 233 dhe 234 K.Pr.Penale ndaj deputetit z. Sali Berisha.

Me Vendimin nr. 117, datë 26.10.2023, Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka vendosur vijimin e masave të sigurimit personal *“Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”* dhe *“Ndalimi i daljes jashtë shtetit”*, ndaj deputetit z. Sali Berisha.

Me Vendimin nr. 56, datë 21.11.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka miratuar vendimet nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përsa i përket z. Sali Berisha.

Me Vendimin nr. 520 datë 30.12.2023, Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka vendosur zëvendësimin e masave të sigurimit personal *“Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”* dhe *“Ndalimi i daljes jashtë shtetit”* me masën shtrënguese të sigurimit personal *“arrest në shtëpi”*.

Për ekzekutimin e vendimit të sipërcituar është ngarkuar Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Arben Kraja dhe Enkeleda Millonai.

Ky vendim është ekzekutuar po në datën 30.12.2023.

Për mbikëqyrjen dhe zbatimin e masës së sigurimit *“arrest në shtëpi”* është caktuar Prokuria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në kushtet kur z. Sali Berisha është deputet i Kuvendit të Shqipërisë i zgjedhur nga sovrani, është e domosdoshme që të ushtrojë funksionet e tij si Deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Për këtë arsye duke qënë se ju jeni organ procedues, kërkojmë nga ana juaj miratimin dhe dhënien e lejes që z. Berisha në mënyrën dhe kohën që është aboslutisht e domosdoshme të shkojë, të marrë pjesë dhe të ushtrojë funksionet e tij në seancat plenare të Kuvendit të Shqipërisë, në përmbushje të të drejtave lirive

politike të parashikuara nga Kushtetuta e vendit, por edhe të përmbushë detyrimet e veta kundrejt elektoratit që e ka zgjedhur.

Kërkojmë që të merret në konsideratë nga ana juaj kjo kërkesë jona legjitime dhe nëse e konsideroni të arsyeshme të përcaktoni edhe modalitet e lëvizjen së z. Berisha nga banesa në sallën e sancave plenare si dhe kohën e nevojshme për të realizuar këtë lëvizje vetëm për të marrë pjesë në sallën e sancave plenare ku zhvillon punimet Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Për këto arsye kërkojmë:

- Lejimin e z. Sali Berisha, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, që të marrë pjesë në seancat plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të detyrimit që buron nga ky funksion, si person i zgjedhur nga sovrani, për të ushtruar të drejtat dhe liritë politike sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Duke mbetur në pritje të një përgjigje të shpejtë dhe pozitive nga ana juaj, Ju falenderoj për mirëkuptimin.

Me respekt,

Av. Sokol Mëngjesi

(mbrojtësi me prokurë të posaçme)